

TË ARRITURAT AKADEMIKE TË ADOLESHENTËVE DHE MIRËQENIA
SUBJEKTIVE: ROLI I FAKTORËVE SHKOLLOR

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I ARTEVE NË DREJTIMIN PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE
KËSHILLIM

Nga:

MERVA AVDIU



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

PRISHTINË

KORRIK, 2021

Të arriturat akademike të adoleshentëve dhe mirëqenia subjektive: Roli i faktorëve

shkollor

Nga

Merva Avdiu

Mentorja: Prof. Ass. Dr. Liridona Jemini-Gashi

Mirëqenia subjektive i referohet mënyrës se si njerëzit vlerësojnë jetën e tyre dhe definohet si gjendje e përgjithshme e një individi në aspektin e mirëqenies (Diener, 1984). Së bashku me arritjet akademike janë tregues qendrorë të funksionimit pozitiv psikologjik (Suldo, Riley, & Shaffner, 2006). Ndërsa klima e shkollës bazohet në modelet e përvojave të njerëzve në jetën shkollore dhe pasqyron normat, qëllimet, vlerat, marrëdhëniet ndërpersonale, praktikatat e mësimdhënies dhe të të nxënies dhe strukturat organizative" (Cohen et al., 2009). Klima shkollore dhe arritjet akademike shoqërohen pozitivisht sepse një klimë e mirë shkollore është një parakusht për të mësuar (Thapa et al., 2013). Rreth 87% e studentëve në Kosovë u pajtuan që mësuesi i tyre tregon kënaqësi në mësimdhënie. Kurse sa i përket kënaqësisë me jetën, 82% e studentëve raportuan se janë të kënaqur me jetën e tyre. 92% prej tyre raportuan se ndihen të lumtur, dhe vetëm 4% raportuan se ndihen të mërzhitur (OECD, 2019).

Qëllimi i këtij studimi është që të gjejmë lidhshmërinë mes faktorëve shkollor në mirëqenien subjektive dhe të arriturat akademike, ndikimin e faktorëve shkollor në mirëqenien subjektive dhe të arriturave akademike, dhe dallimin mes faktorëve shkollor në impaktin e tyre në mirëqenien subjektive dhe në të arrituar akademike në kontekstin lokal.

Ky studim mundohet të përgjigjet në këto pyetje kërkimore: cila është lidhshmëria e raportit interpersonal të nxëniesit me kënaqësinë me jetën ? Cili është dallimi mes meshkujve dhe femrave në zbatimin e rregullave të shkollës ? Si ndikon kualiteti i marrëdhënieve mësimdhënës-

nxënës në lidhshmërinë e nxënësve me shkollën ? dhe si ndikojnë notat në optimizmin e nxënësve ? Nga pyetjet kërkimore janë ngritur dhe parashtruar dhe hipotezat e studimit, duke theksuar hipotezat se kualiteti i marrëdhënieve mësimdhënës-nxënës ndikon pozitivisht në lidhshmërinë e nxënësve me shkollën, dhe, notat kanë ndikim pozitiv në optimizmin e nxënësve.

Instrument i përdorur janë pyetësorët të ndarë në tre qëllime studimi: klimën shkollore, mirëqenien subjektive dhe variablat demografike. Ky studim është korelacional, me N= 161 nxënës të shkollave të mesme të Mitrovicës, të përzgjedhur përmes mostrimit të qëllimshëm. Nga pikëpamja gjinore 72.7% (N=114) kanë qenë femra, dhe 27.3% (N=44) kanë qenë meshkuj. Sa i përket moshës, 16.8% (N=27) prej tyre kanë qenë të moshës 15 vjeç, 42.8% (N=69) të moshës 16 vjeç, 26.7% (N=43) kanë qenë të moshës 17 vjeç, dhe 13% (N=21) kanë qenë të moshës 18 vjeç. Prej tyre 39.2% (N=62) kanë ndjekur klasën e dhjetë, 45.6% (N=72) klasën e njëmbëdhjetë, dhe 15.2% (N=24) kanë ndjekur klasën e dymbëdhjetë.

Për analizimin e të dhënave së pari është përdorur analiza e shpërndarjes normale së të dhënave dhe pasi që të dhënat kishin shpërndarje normale, për të gjetur ndërlidhjen ndërmjet marrëdhënieve interpersonale dhe kënaqësisë me jetën është përdorur korelacioni i Pearsonit. Ndërsa për të gjetur dallimet gjinore në të kuptuarit dhe zbatuarit e rregullave të shkollës është përdorur T-testi. Po ashtu është përdorur dhe analiza statistikore e regresionit të shumëfishtë linear, për të parë nëse faktorët shkollor janë parashikues të mirëqenies subjektive. Po ashtu analizat deskriptive janë përdorur dhe në rastin e analizimit të variablave demografike.

Rezultatet e korelacionit të Pearsonit, tregojnë se në mes raporteve interpersonale të adoleshentëve me shoqëri, dhe të qenurit të kënaqur me gjendjen aktuale ekziston korelacion pozitiv i nivelit të moderuar me domethënie statistikore [$r = .196^*$; $p = 0.14$]. Poashtu rezultatet e korelacionit të Pearsonit, tregojnë se në mes raporteve interpersonale të adoleshentëve me

shoqëri, konkretisht me të qenurit të pranuar në shoqëri që është dimension i rëndësishëm i saj, dhe të qenurit të kënaqur me gjendjen aktuale ekziston korrelacion pozitiv i nivelit të moderuar me domethënie statistikore [$r = .196^*$; $p = 0.14$].

Përmes analizës së regresionit të shumëfishtë linear është parashikuar marrëdhënia në mës të mësimdhënësve dhe nxënësve (konkretisht në atë se sa janë të gatshëm mësime të mësimdhënësve të t'i dëgjojnë ata e të interesohen për ta), duke u bazuar pastaj në lidhshmërinë e tyre me shkollën. Ashtu siç mund të shihet në tabelën shtatë, rezultatet tregojnë se ekuacioni regresional është signifikant $F(3,197) = 39.724$, ($p = .001$), $R\text{ square} = 0.390$. Në këtë mënyrë shihet se dimensionet e marrëdhënies mësime-dhënës-nxënës janë parashikues signifikant të lidhshmërisë së nxënësve me shkollën. Specifikisht shihet që rreth 39 % e lidhshmërisë së nxënësve me shkollën parashikohet nga marrëdhënia me mësime-dhënësit e tyre.

Përsëri me anë të regresionit të shumëfishtë linear është parashikuar nota mesatare e nxënësve, duke u bazuar pastaj në mirëqenien subjektive. Ashtu siç mund të shihet në tabelën tetë, rezultatet tregojnë se ekuacioni regresional është signifikant $F(0,925)$ ($p = .018$), $R\text{ square} = 0.058$. Në këtë mënyrë shihet se të arriturat akademike janë parashikues të moderuar të mirëqenies subjektive. Specifikisht shihet që rreth 5.8 % e mirëqenies subjektive parashikohet nga të arriturat akademike.

Duke u bazuar në gjetjet e këtij studimi, rekomandohet që qeveria e Kosovës, politikëbërësit, reformatoret e arsimit dhe administratorët e shkollës duhet të sigurojnë që shkollat të kenë pajisje të përshtatshme për mësime dhe mësime, sporte dhe lojëra, si dhe teknologji të komunikimit të informacionit dhe lidhje interneti. Poashtu edhe kurrikula shkollë duhet të theksojë edukimin shëndetësor dhe emocional për të rritur mirëqenien subjektive tek nxënësit.

